

# Berati, mes monu- menteve të ardhshme

nga Shpend Sollaku Noë

**N**ë datat 12 e 13 prill Berati po përgatitet të shndërrohet de facto në kërkthizën kulturore të Shqipërisë. Duke u nisur nga një nismë e ATSH-së (Flora Nikolla e Nini Mano) e sipas përvojës së fituar nga Albanian Excellence të nëntorit të kaluar, qyteti ka hapur krahët të përqafojë bijtë e vet të shquar në Shqipëri e diasporë si dhe shumë personalitete të tjera të lidhura në një farë mënyre me të. «Berat Excellence» – kështu quhet aktiviteti, është një përpjekje serioze e shumë e rëndësishme për tërheqjen e vëmendjes jo vetëm të shqiptarëve për

ringjalljen e këtij qyteti – Trashëgimi e Njerëzimit – të lënë në mëshirën e fatit. Veprimtaritë e shumta të programuara që zhvillohen në ato dy ditë lënë të kuptojnë realizimin e një feste me përmasat e një revolucioni kulturor, që është vështirë të mos ketë edhe pasojë politike. Prania e të huajve (nuk e kam fjalën tek i zakonshmi servilizëm kulturor ndaj tyre) i jep «Berat Excellence» detyrimisht një kadenzë ndërkom-bëtare. Por, që të mos skuqemi prej turpit, sugjeroj që ata, të huajt, të paktën t'i hidhni me parashutë, matanë Urës së Goricës, pasi nuk ka gojë që mund të shfaqë asnjë askënd për gjendjen e rrugëve që

të çojnë në qytetin më të rëndësishëm shqiptar për vlera antike. Rreth braktisjes së Beratit tonë nuk mjaftojnë fjalorë të tërë plot me fjalë zemërimi për të shprehur atë mllef që ndjen gjithkush që e do sinqerisht vendin tij. Sidoqoftë, ata që do të vijnë nga jashtë nuk kanë për të sjellë vetëm zemërim për gjendjen. Dikush do të hapë një ekspozitë, dikush i dhuron bibliotekës së varfër librat e tij, dikush një film e një tjetër zërin për të kënduar, ndokush edhe ka prodhuar bluzat tematike. Të gjitha këto me shpenzimet e tyre, duke filluar nga biletat e avionëve, tek restorantet e hotelet. Të ardhurit e quajnë veten vërtetë

të nderuar që janë të ftuar, por edhe ata i bëjnë nder Beratit të varfëruar, që u ofron me bujaritë që mundet: admirimin dhe nguljen në kujtesë. Të shumtë janë beratasit e angazhuar në këtë festë, por unë do të veçoja të paktën dy prej bijve më të mirë të tij: E para është Nini Mano. Është fyerje për ndershmërinë që atë çka bën kjo zonjë e nderuar ta quash punë. Angazhimi i saj është pasion i pastër, është vetmohim. I dyti është Thoma Jançe. Rallë mund të gjesh njerëz si ai që shkrinë nerva, para e kohë të çmuar në emër të dashurisë për qytetin e tij mijëra-veçar, të pasionit për ligjësinë, për moralin, të dëshirës për t'i dhënë një shpresë të rinjve. Nëse në ato dy ditë Berati do të përqafojë bijtë e tij më të mirë, kjo do të thotë që monumentet e reja që këtij qyteti i mungojnë i kanë gjetur emrat e tyre. Mjafton vetëm të sigurohen fondet për mermerin, apo bronxin. Monumente për të gjallët. Pasi edhe e sotmja është histori. Si ajo që do të shkruhet nga vetë Berati më 12 e 13 prill.

**J**o çdo president është një lider, por çdo herë që zgjedhim një president, ne shpresojmë që ai të jetë i tillë, veçanërisht në kohë pasigurie dhe krizash.

Në kohëra të kollajshme ne jemi ambivalentë – lideri, në fund të fundit, ka kërkesa, sfidon status quo-në, i shkundullon gjërat. Lidershipi është po aq një çështje e çastit kohor, sa e çdo gjëje tjetër. Lideri duhet të dalë në skenë në një moment kur njerëzit janë duke e kërkuar një udhëheqje, siç bëri Churchill-i në 1940, Roosvelt-i në 1933, apo Lenini në 1917. Dhe kur të vijë, ai duhet të ofrojë një mesazh të thjeshtë por të fuqishëm (elokuent). Liderët e mëdhenj janë pothuajse gjithmonë thjeshtëzues të mëdhenj, që i bien shkurt argumentit, debatojnë dhe shtëmëngen me dhënë një zgjidhje, të cilën ta kuptojnë dhe mbajnë mend të gjithë. Churchill-i paralajmëronte britanikët të prisnin "gjak, stërmundime, lotë dhe djersë"; Roosvelt-i u thonte amerikanëve që "e vetmja gjë të cilës duhet t'ia kemi frikën është vetë frika"; Lenini u premtojte rusëve të drobitur nga lufta, paqe, tokë dhe bukë. Mesazhe të pazbukuruara, por të fuqishme. Ne kemi një imazh të asaj se çfarë duhet me qenë një lider. Ne madje njohim shenjat fizike: liderat mund të mos jenë domosdoshmërisht të gjatë, por ata duhet të kenë tipare të spikatura, më-të mëdha-se-je-ta – hunda dhe butat e veshëve të Lyndon B. Johnson-it; e qeshura vesh më vesh e Eisenhower-it. Një stampë na vjen gjithashtu në ndihmë: cilindri i gjatë si oxhak i Lincoln-it, karriget lëkundëse të J.F.Kennedy-t. Ne duam që lideri ynë të dallohet disi mbi të tjerët, jo të jetë si njerëzit e zakonshëm. Gjysma e shqetësimeve të Presidentit Ford vinte nga fakti që, nëse ju do t'i mbyllnit sytë për një

# Çfarë e bën liderin

nga Michael Korda

çast, s'do të mundeshit të kujtonit fytyrën e tij, figurën apo veshjet. Një lider duhet me pasë një identitet të paharrueshëm, të ngulitur menjëherë e përgjithmonë në mendjet e njerëzve. Një lideri i bën fajde nëse mundet të kryejë diçka që shumë prej nesh s'munden; F.D.Roosevelt mposhti poliometilin; Mao-ja notoi në lumin Jance në moshën 72 vjeç. Ne nuk duam që liderat tanë të jenë "thjesht njëlloj si ne". Ne i duam ata të jenë si ne, por më të mirë, specialë, më tepër kësodore. Ndërkaq, nëse ata janë shumë të ndryshëm, ne i refuzojmë. Adlai Stevenson ishte shumë cerebral. Nelson Rockefeller, shumë i pasur. Madje dhe televizioni, i cili vjen bashkë me çokitjet si një imazh-ndërtues që zmadhon formën mbi thelbin, nuk mundet të errësojë krejtësisht cilësitë e leadershipit që ne i njohim, ose mungesën e tyre. Televizioni ekspozoi pasigurinë e Nixon-it, marrosjen fatale të Humphrey-t me zërin e vet. Një lider duhet të di si ta përdorë pushtetin (në fakt, ky është leadershipi), por ai duhet të ketë dhe një mënyrë që të tregojë se po e bën këtë. Ai duhet të jetë i aftë të projektojë qendrueshmëri – pa ngathtësi fizike (si Ford-i), pa rrotullime të shpejta sysh (si Carter). Një filozof kinez ka thënë dikur se një lider duhet të ketë hijeshinë e një valltari të mirë, dhe ka shumë mençuri në këtë thënie. Një lider duhet të dijë si të shfaqet i çlirët dhe besimplotë. E ecuria e tij duhet të jetë e ngulët dhe e paracaktuar. Ai duhet të jetë i aftë – si Lincoln-i, Roosvelt-i, Truman-i, Eisenhower-i dhe Kennedy, - të bëjë

një të qeshur të fortë, me gjithë zemër, në vend të gajasjes vesh më vesh të Nixon-it apo Carter-it që rreken ta quajnë humor. Përgatitja e Reagan-it si aktor pati ndikim të ndjeshëm në debatin me Carter-in, kur përmes manierave të zhdërvjellëta dhe mirësjelljes së dallueshme, ai ia doli të përçojë përshtypjen se në fakt presidenti ishte ai, ndërsa Carter-ri sfidant. Nëse e dimë çfarë jemi duke kërkuar, pse është kaq e vështirë me e gjetë? Përgjigjja qendron në një të vërtetë shumë të thjeshtë përreth leadershipit. Njerëzit mund të udhëhiqen vetëm për atje ku ata duan të shkojnë. Lideri ndjek, megjithëse një hap përpara. Amerikanët donin ta kapërcenin Depresionin dhe kishin nevojë për dikë që t'u thonte se ata mundeshin, dhe Roosvelt-i këtë bëri. Britanikët besonin se ata ende mund ta fitonin luftën edhe pas disfatave të 1940-ës, dhe Churchill-i u tha atyre se ata e kishin mirë. Një lider qëndron sipër valëve, lëviz sipas baticave, kupton aspiratat më të thella të popullit të vet. Ai s'mundet ta shpjerë në luftë një komb që do paqen me çdo çmim, ose ta ndalojë një komb të vendosur për të luftuar, ta bëjë këtë. Qëllimi i tij duhet t'i përputhet gjendjes shpirtërore të kombit. Detyra e tij është të fokusojë dëshirat dhe energjitë e popullit, të përcaktojë ato në terma të thjeshta, të frymëzojë, të bëjë ato çka populli tashmë kërkon të duken të arritshme, të rëndësishme, brenda rrezes së kapjes. Mbi të gjitha, ai duhet t'u japë dinjitet dëshirave tona, të na bindë se jemi duke marrë pjesë në bërjen e një historie të madhe, të na japë një

ndjesi lavdie për veten tonë. Winston Churchill-i ia doli, veç përmes retorikës, ta kthente humbjen e britanikëve dhe evakuimin e Dunkirk-ut në 1940 në një fitore të madhe. Fjalët e F.D.Roosevelt-it e kthyen mbytjen e flotës amerikane në Pearl Harbor në një kushtrim kombëtar për luftë, në vend të një skandali kombëtar poshtëruës. Një lider duhet të bëjë të na lëvrijë gjaku (na ndezë gjakun) - dhe jo t'i bëjë thirrje arsyes sonë... Një lider i madh duhet të ketë një cilësi të caktuar irracionaliteti, një refuzim kryeneç për t'u përballur me faktet, një optimizëm infektues, aftësinë për të na bindur se jo gjithçka është e humbur, edhe kur ne kemi frikë se po. Konfuci sugjeronte se, ndërsa këshilltarët e një lideri duhet të ishin të ftohtë si akulli, lideri vetë duhet të ishte si zjarr, një shkëndijë e çmendurisë hyjnore. Ai nuk do të vijë deri sa ne të jemi gati për të, pasi lideri është si një pasqyrë, që reflekton ndjenjat e qëllimit tonë, duke i shprehur në fjalë vetë ëndrrat dhe shpresat tona, duke i transformuar nevojat dhe frikërat tona në politika koherente dhe programe. Forca jonë e bën atë të fortë; vendosmëria jonë e bën atë të vendosur; guximi ynë e bën atë të një hero; ai është, në analizë të fundit, simboli i më të mirës sonë, të formësuar prej shpirtit dhe vullnetit tonë. Dhe kur këto cilësi mungojnë të neve, ne s'mund ta prodhojmë atë; dhe madje me gjithë shkathtësinë tonë imazh-ndërtuese, ne s'mund ta shpërbejmë atë. Ai është, në fund të fundit, veçse shuma e të gjithë neve. **Përktheu: Neritan Kolgjini**